

INTERVISTË ME HIDAJETE OSMANI BYTYQIN

Prizren | Data: 3 gusht, 2022

Kohëzgjatja: 73 minuta

Të pranishëm:

- Hidajete Osmani Bytyqi (e Intervistuar)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Hidajete, nëse mundeni me u prezantu, vitin e lindjen, vendin, diçka për prejardhjen e familjen e ju t'parë?

Hidajete Osmani Bytyqi: Unë jam Hidajete Osmani e lindur në fshatin Makresh i Ulët. Atëherë ka qenë Komuna e Gjilanit sa e di unë, tash osht' me komunën e Novobërdës. Prindërit e mi janë Kadri Osmani dhe Shukrie Bunjaku. Një vit kemi qëndru aty pas lindjes time dhe pastaj jemi shpërngulë në Gjilan. Në vitin '63 jemi shpërngulë në Prishtinë. Aty kanë fillu edhe shkollimin prej klasës të parë deri në përfundim të Fakultetit Letërsi dhe Gjuhë shqipe.

Po krejt kjo rrugë deri në përfundimin e fakultetit ka ngjarje të ndryshme duke filluar prej burgosjes së parë të babës. Në vitin '69 deshi të organizoj një përkujtim për ngjarjet e demonstratën e vitit '68 ku kishte qenë pjesëmarrës edhe ai. Përmes një trakti të shkruar, njërit ia kishte dhënë në besim dhe siç kanë thënë, ai person e ka dorëzuar në Sekretariatit e Punëve të Brendshme dhe baba është burgosë.

Anita Susuri: A ju kujtohet juve paraprakisht po du me ju pytë '68-ten, ju keni qenë fëmi, a ju kujtohet për shembull aktiviteti i babës të ju në organizimin e demonstratave? A ka qenë pjesëmarrës a veç...

Hidajete Osmani Bytyqi: Në vitin '68 nuk më kujtohet shumë mirë për në organizim çka ka marrë pjesë, po që ka qenë pjesëmarrës në demonstratë ka qenë pjesëmarrës. Për përvjetorin është, ka qenë ma aktiv, ka qenë i kyçun me shokë edhe e kanë bërë shkrimin e atij trakti. Atëherë sa e di ka qenë një muaj ka qëndru në burg. E në vitin '71 është burgosë përsëri e në vitin '74 është burgosë... në vitin '71 është burgosë për çështjen si i rrezikshëm se ka pasë ardhë Tito për vizitë në Kosovë.

Në vitin '74 e mbaj mend ma mirë, më kujtohet, atëherë kemi pasë fillu aktivitetin edhe unë dhe e kam pasë formu treshen e parë, celulën e parë me shoqen e klasës Sevdije Grajçevcin, kushërina e Fazli Grajçevcit. Për atë arsye jemi... për Fazli Grajçevcin sigurisht e dini dhe keni dëgju. Dhe me Haxhere Sylën, motrën e Gani Sylës edhe ai i burgosur politik tanimë i ndjerë. '74-ten baba është dënu me nëntë vite burg.

Peripetitë e familjes dihen. Të ardhura nuk kemi pasë për të jetu po shokët e babës të cilët kanë mbetë jashtë, Gani Sylja, Mehmet Hajrizi na kanë ndihmu. Për vizita, për ushqim, për shkollim, për të gjitha me mjete materiale. Shtëpinë e kemi pasë ble te Konviktet e Studentëve...

Anita Susuri: Qysh ka qenë qajo jeta e juj në Prishtinë si fëmi? Qysh e kujtoni me krejt këtë problemë me babën e juj? Qysh ka vazhdu dinamika e familjes?

Hidajete Osmani Bytyqi: Familjarët na kanë qëndru pranë, sidomos dajhtë, axhallarët, hallat. Po një dajë në veçanti, për me dallu prej të tjerëve, është Mustafë Bunjaku. Ata i kanë pasë marrë në pyetje i kanë pasë torturu edhe fizikisht po materialisht na ka ndihmu shumë. Mandej edhe rrethi shoqëror. Për në vizitë më kujtohet niherë nuk kemi pasë shku te baba nja dy vjet, se ka qenë në Slloveni. Aq shumë u rrit vllau sa që kur kemi shku në vizitë baba nuk e ka njoftë. Tha, “Kush osht’ ky?” Na metëm të habitun se nuk na murr menja që mundet mos me njoftë djalë. Po dy vite për fëmi janë shumë për zhvillim me pa.

Anita Susuri: Atëherë domethonë...

Hidajete Osmani Bytyqi: Atëherë, për atë vizitë na ka pasë siguri të hollat një shoqe bashkë me burrin, Vahide Braha edhe [Meriman Braha](#). S’di për ata a keni dëgju...

Anita Susuri: Po, po.

Hidajete Osmani Bytyqi: Jeta ka qenë e vështirë, po dëshira për shkollim nuk ka mungu me gjithë ato vështirësi. Po përparësia për ne ka qenë se kemi qenë banor të Prishtinës. Me siguri me pasë qenë, me pasë jetu në Gjilan qysh e kemi pasë shtëpinë, unë nuk kisha arritë me kry fakultetin. Kjo ka qenë në përparësi shumë e madhe. Se e kemi pasë fakultetin afër.

Anita Susuri: E mundësitë materiale kanë qenë të dobëta...

Hidajete Osmani Bytyqi: E libra kemi pasë mjaft. Ka pasë edhe nëpër librari, nëpër biblioteka po mendoj, po edhe shtëpinë e kemi pasë të mbushura me libra. Se baba nuk ka ndodhë me dalë niherë në qytet e mos me sjellë në libër në shtëpi. I kom edhe jashtë krejt bibliotekën e babës e kam tash këtu.

Anita Susuri: Po më intereson tash baba kur osht’ burgosë në ‘74-ten osht’ dërgu në Slloveni në burgje apo?

Hidajete Osmani Bytyqi: Po.

Anita Susuri: A ju kujtohet për shembull vizita e parë, qysh osht’ organizu? Keni shku me tren a qysh keni shku?

Hidajete Osmani Bytyqi: Me tren kemi shku. Niherë me tren. Me nanën edhe me vëllaun kemi shku, ka qenë edhe në burgun qendror në Beograd, në Ceze i thoshin atëherë burgut qendror. Kemi shku në Beograd nja dy herë, në Maribor, në Lublanë kemi shku me tren. E niherë në Maribon kemi shku me ni veturë t'ni dhëndrri jonë na ka çu, burri i vajzës së axhës. Ka pasë njerëz solidar që me mjete materiale kanë qenë mirë e na kanë qëndru pranë. Të cilët shfrytëzoj rastin t'i falënderoj kështu.

[Paragrafi në vijim është shtuar me kërkesë të folëses]

Me rastin e burgosjes së babait tim, më 5 maj 1974, janë maltretuar edhe fizikisht edhe tre dajallarët e mi, (vëllezërit e nënës): Mustafë, Sylejman e Rrahman Bunjaku, ngase në shtëpitë e tyre janë strehuar njerëz dhe material ilegal, që i dërgonte babai ynë. Daja Mustafë bile ka marrë pjesë edhe në bartjen dhe fshehjen e makinave të shtypit nga shtëpia jonë e deri në Taukbashqë. Për këtë arsye UDB-ja i ka rrahur shumë. Po në shtëpitë e tyre është strehuar edhe djali i axhës sonë Begzadit (i burgosur politik edhe ky), Lulëzim Osmani, kur ka ikur nga ushtria e ish RSFJ-ës. Pra edhe familjet e familjarët kanë qenë të përfshirë në aktivitetin politik.

Anita Susuri: E këto udhëtimet çfare kanë qenë për shembull? A keni dërgu ndoshta edhe ushqime a libra a diçka qysh kanë qenë kontrollat aty nëpër burgje? Qysh ka qenë krejt përjetimi, qysh e kujton?

Hidajete Osmani Bytyqi: Ushqimi ka qenë i kufizun, sa me i dërgu pakot po nuk më kujtohet nga vendi në vend gjithmonë. Po kontrollat kanë qenë deri në detalet. Të gjitha paketimet çka kanë qenë të paketune i kanë çelë, i kanë...

Anita Susuri: Kanë kontrollu për sene...

Hidajete Osmani Bytyqi: E kanë kontrollu çdo sen. Po shpesh s'kemi mujtë me shku në vizita po kaniherë pakot i kemi dërgu edhe me postë.

Anita Susuri: A ka ndodhë ndonjëherë që ju kanë kthy pa e pa për shembull babën për ndonjë arsye? Me ju kthy pa u taku hiç?

Hidajete Osmani Bytyqi: Ka ndodhë në Mitrovicë sa më kujtohet. Në Mitrovicë. Se baba ka qenë ma temperament ata i kanë thanë me folë serbisht, nuk ka dashtë e ka ndërpre vizitën edhe jemi kthy edhe pa e pa.

Anita Susuri: E baba ju j kur ka dalë prej burgut, po i bjen cili vit ka qenë afërsisht? '74-ten thatë u burgosë

Hidajete Osmani Bytyqi: '83-ten se edhe foton që e patëm aty ishte në 83-ten.

Anita Susuri: A kanë vazhdu prapë...

Hidajete Osmani Bytyqi: ‘83-ten. Tetë muaj ka qëndru jashtë. Vetëm tetë muaj dhe përsëri osht’ burgosë. Atëherë është dënu me 15 vite burg.

Anita Susuri: E para se me vazhdu anej po du me ju pytë a ka pasë edhe pasi ka dalë prej burgut me ardhë, për shembull, në shpi kontrolla ose e kanë thirrë në pyetje në biseda...

Hidajete Osmani Bytyqi: ‘74-ten nuk ka pasë kohë me marrë në biseda informative se tetë muj ka qenë në pyetje edhe e kanë burgosë. Ka qenë i burgosur vazhdimisht. Po në ‘74-ten kur osht’ burgosë kemi pasë shtëpinë rrëmujë nga kontrollat. Nëna insistonte edhe i ka pasë detyru, se ata hynin me këpucë brenda, nana ju ka qëndru te dera derisa u detyrun me... “Ku po shkoni ju me m’hy këtu me këpuca kah keni shku kah keni, me hy me këpuca në shtëpinë time, kurrë”, edhe i ka shti m’u dathë. Ishin disa shqiptarë edhe e dëgjun e u dathën.

Aty ka pasë, në shtëpinë tonë, e kanë pasë ndërtu me këtë Mehmet Hajrizin ni bunker. Dhomën e kanë çelë e kanë grry e kanë pasë ndërtu dy me dy poshtë nën dhomë. Me kapak edhe kanë qenë dy shaptilograf për shumëzimin e trakteve edhe maqina e shkrimit. Kur shkruante ai, baba, Kadri Osmani, na i diktojshim. Se ai shkrunte me dorë pastaj në makinë me diktalografim. Nana edhe pse shkollë nuk ka po ka qenë autodidakte, ka mësu...

Anita Susuri: Ka ndihmu edhe ajo.

Hidajete Osmani Bytyqi: Ka ndihmu edhe ajo, i ka dikt. Ka qenë përkrahëse. Kurrë nuk e ka kundërshtu me gjithë hjekat çka i ka pasë e çka ka vuajt ajo. Po gjithmonë e ka përkrahë.

Anita Susuri: E këto traktet e babës, çfarë përmbajtje kanë pasë për shembull? Për me vetëdijësu...

Hidajete Osmani Bytyqi: Me vetëdijësu popullin, me ftu, me u ngrit vetëdijën kombëtare për liri. Atëherë ishte kërkesa për Kosovën Republikë, në kuadër të Jugosllavisë me qenë e barabartë. Në shtëpinë tonë ka dalë së pari, revista “Zëri i Kosovës”.

Anita Susuri: Është shtypë...

Hidajete Osmani Bytyqi: Gjashtë numrat e parë janë shtypë në shtëpinë tonë. Emri ju ka vendosë... ne na ka pasë pytë baba disa emra të cilët, e më kujtohet unë edhe nana i tham, “Zëri i Kosovës”, me ngrit zanin për gjithë popullin, për liri. U përkrah edhe prej të tjerëve edhe e pagëzun “Zëri i Kosovës”. Mandej ai ka vazhdu jashtë me të tjerët, ia ka ndrru emrin herë “Liria” herë s’di çka, me Jusuf Gërvallën e të tjerët. Po “Zëri i Kosovës” në shtëpinë tonë ka lind.

Anita Susuri: A ka qenë revistë e madhe ajo? A ka qenë me shumë faqe a qysh ka qenë?

Hidajete Osmani Bytyqi: Revistë me plot kuptimin e fjalës. Po na i kanë marrë ato. A janë dikund nëpër arkiva, na nuk i kemi tash. Po ka pasë vjerrsha, tregime, pamfleta, trakte, krijime të ndryshme po revistë.

Anita Susuri: Sa, për shembull, sa ka qenë numri afërsisht që është shtypë qajo revistë?

Hidajete Osmani Bytyqi: Sasia e një numri? Gjashtë numra kanë dalë. Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë. I gjashti ka ra n'dorë të dikujt edhe është bo burgosja me 04 maj, me 05 maj të vitit 1974.

Anita Susuri: Tirazhi i madh, numri...

Hidajete Osmani Bytyqi: Nuk e di, nuk e di. Kam qenë, cilën klasë po i bjen me qenë unë atëherë...

Anita Susuri: Po shumë e vogël, klasën e dytë ose të tretë. Në atë momentin që thatë që kanë ardhë me ju shti me kontrollu, a e kanë gjetë qat' bunkerin?

Hidajete Osmani Bytyqi: Herën e parë nuk e kanë gjetë. Pastaj herën e dytë pas provokimeve çka kanë ndodhë, si kanë ndodhë na i kemi tërheqë ato makinat se e kemi ditë që janë, për mos me u zbulu. Përmes dajve që thashë i kanë burgosë edhe dajtë. I kemi marrë, i kemi qit' në këto karrocate dorës që ndërtoheshin materiale të shtëpive ndërtimore, që edhe i kemi çu te dajtë. I kemi çu në Taukbahçe me ni prrockë është atje poshtë edhe i kemi lanë atje.

Po në ndërkohë kanë ardhë këta përsëri se janë ba shumë kontrolla të vazhdueshme. Kanë ardhë e kanë gjetë si vend. Ni shtaptilograf ka qenë ma i madh, ata s'kemi mujtë me hjekë. Jo që s'kemi pasë, e dishim që është shtëpia nën vëzhgim, s'kishim mundësi. Kur kanë ardhë e kanë gjetë, e kanë gjetë pra shtaptilografin e madh. Tani e kanë mbyllë. Kanë shku e kanë marrë babën e kanë pru aty. Tash baba nuk e ka ditë çka ka, çka s'ka. Ka mendu që janë t'gjitha aty edhe e ka pranu. Tani u tekën n'neve.

Nanën e kanë marrë në pyetje e kanë majtë me orë të tana derisa njëni, një Metush Sadiku, punëtor i sigurimit e ka pasë djalit me vllaun tonë të voglin, me Ylberin e kanë pasë me ni klasë. Ju ka betu në kokën e djalit, "O pranoje, s'po vijmë me juve, gjeni ku keni çu sillni këtu se Kadriu e ka pranë që janë". Jemi detyru, kemi shku, i kemi marrë edhe i kemi dorëzu.

Anita Susuri: Ju familjarisht domethonë e keni ditë që ekziston lëvizja ilegale? Se shumica edhe e kanë mbajtur msheft në familje.

Hidajete Osmani Bytyqi: Po, jo na, unë...

Anita Susuri: Qysh ka qenë ideja juj për shembull, qëndrimi juj?

Hidajete Osmani Bytyqi: Prej atëherë ne e kemi pasë në kokë luftën për çlirimin e Kosovës, si fëmi. Gjithmonë, edhe sot e kemi shqiponjën këtu, edhe gjithmonë e kemi pasë prej kur është leju edhe kur nuk ka qenë e lejune e le më masi është leju, prej murit flamuri nuk është heqë.

Anita Susuri: Ju po thoni, domethonë, '74-ten në fakt në '71-ten që ka pasë me ardhë Titoja, a është mbajtë gjatë në burg apo veç qat' muj a qysh ka qenë?

Hidajete Osmani Bytyqi: Atëherë ka qenë i dënun baba dhetë muaj sa m'kujtohet po është liru me mbrojtje n'liri. Kur e kanë burgosë për çështjen e vizitës, atëherë për mos me leju me dalë se osht' fjalosë me atë drejtorin e burgut e kanë gjetë ata ende pa u marrë vendimi i plotfuqishëm për ata muajt e tjerë e kanë marrë dhe e kanë çu në Nish. Në Nish kemi qenë në vizitë.

Anita Susuri: A kanë qenë këto shkuarja deri atje për juve shqetësuese? Qysh jeni ndje ju për shembull si fëmi?

Hidajete Osmani Bytyqi: Ne gjithmonë kemi qenë krenar por edhe e kemi përkrah babën edhe familja... atje na ka pasë çu n'vizitë axha. Edhe ai pastaj osht' burgosë Begzat Osmani. Ka sjellë libra bashkë me vëllaun e tij Avdi Osmanin përmes Ambasadës të Beogradit. Nuk di kahit, shqiptare Ambasadës së Shqipërisë. Në Austri ata kanë punu. Prej Shqipërie në Austri, qysh i kanë bajtë nuk e di librat po ata i kanë sjellë librat pastaj këtu në Kosovë. Për atë arsye edhe është burgosë edhe axha dhe është dënu 12 vjet a tri i ka mbajtë, Begzat Osmani.

Anita Susuri: Në rrethin që keni jetu, për shembull, me familjarët me të largët, a ka pasë paragjytime prej anës t'tyne për familjen e juj?

Hidajete Osmani Bytyqi: Ka pasë, ka pasë të tjerët kanë qenë, më kujtohet bile niherë ni kusheri erdh me pa babën i tha, "Kadri, u kry kjo punë tash mbledhi mendët edhe kqyre shpijen. Hin n'punë kqyre familjen tane. Le se nuk shtyhet me shtet", tha, "Pse? Ku janë mendët m'i mbledhë? Pata me marrë ni krojshe me dalë m'i mbledhë mendët, a janë dredhza ato a çka janë? Nuk di ku mbledhen", si n'tallje.

Anita Susuri: N'shkollë prej juve a ka pasë për shembull prej mësimdhënësve, prej shokve, shoqeve? Si me thanë, distancë...

Hidajete Osmani Bytyqi: Shoqe, rrethi i ngushtë kanë qenë në përkrahje, kemi qenë gjithmonë bashkë. Nuk kom pasë shoqe që me më injoru e shoqet i kom pasë shoqërinë e zgjedhur. Të gjithë e kanë ditë edhe ata që kanë dëgju kush, qysh, vajza e kujt. Jemi ofru derisa '81-ten edhe shpërthyn

demonstratat ku kemi qenë të gjithë bashkë. Po fatin e kom pasë, jo vetëm unë, po në atë rrethin e ngushtë shoqëror prej shoqeve vetëm unë jam burgosë.

Se çështja e heshtjes, mos pranimit, mos tregimit, mos me i përmend emrat e shokëve e të shoqeve ka qenë qëllimi kryesor të cilin jam përpjekë, jom mundu edhe emrat e shoqeve nuk i kom tregu. Në burg pastaj atje jom, paraprakisht e kom njoftë edhe [Hatmonen](#) edhe [Zyrafeten](#). Po nuk kemi qenë kështu në lidhje përpara n'celulë, nuk kemi qenë. Po n'burg jemi taku, e kemi vazhdu shoqërinë, kemi përkrahë njana tjetren me aq sa kemi mujtë.

Anita Susuri: Ju thatë që n'shkollë t'mesme e keni formu celulën e parë...

Hidajete Osmani Bytyqi: Po, në shkollë t'mesme me Sevdije Grajçevcin edhe Haxhere Sylën.

Anita Susuri: Këto veç i keni njoftë ndoshta? Familjet e tyre, prejardhjet, keni besu...

Hidajete Osmani Bytyqi: Po, po, po.

Anita Susuri: Edhe qysh ka vazhdu krejt ai aktiviteti juj për shembull? Mbledhjet?

Hidajete Osmani Bytyqi: Ajo mas burgosjes të babës ajo ka ndodhë në '71-'72, '73. Mas burgosjes të babës mandej ma me ato vajza nuk kemi kontakti.

Anita Susuri: E deri në atë...

Hidajete Osmani Bytyqi: Se ishim të, familja gjithmonë e përcjellur, shtëpia gjithmonë nën vëzhgimin e UDB-së. Për t'i kursy ato. Se pastaj... vëllau i Haxheres, Gani Sylaj me Mehmet Hajrizin, ata e kanë vazhdu punën. Ata janë burgosë disa vite, disa vite ma vonë kur kanë ra vet në sy se baba nuk i ka përmend emrat e tyre me rastin e burgosjes t'vet.

Anita Susuri: E baba juj ka qenë n'grup me Mehmet Hajrizin?

Hidajete Osmani Bytyqi: Po.

Anita Susuri: Ata po m'dukët shumë vite të gjata nuk kanë ra në burg...

Hidajete Osmani Bytyqi: Mehmet Hajrizi ka qenë që e kanë punu atë bunkerin qatë bashkë. E domethonë kanë kalu vite e vite ata aktivitetin e kanë vazhdu. Emri i tyre prej babës nuk është përmend.

Anita Susuri: Deshta me ju pytë për aktivitetet që i keni bo, a keni shpërnda këto trakte apo keni shkru edhe parolla? Çka ka qenë detyra juj?

Hidajete Osmani Bytyqi: Në vitin, 100 vjetorin e Lidhjes së Prizrenit, nuk di kush e ka shkru ni trakt, djali i hallës ma ka dhanë. Atë trakt e kemi përcjellë pastaj me të gjithë. E kemi kopju me dorë, e kemi... se atëherë shumëzuese sikur tash nuk ka pasë. E kemi shpërnda sa kemi mujtë. Aty ka qenë 100 vjetori i Lidhjes së Prizrenit, ka qenë një nxitje shumë e madhe, ni vetëdijësim i gjithë studentëve të familjeve, 100 vjetori i Lidhjes së Prizrenit.

Anita Susuri: A ju kujtohet diku përafërt për shembull çfarë përmbajtje ka pasë? Po kuptoj që ka qenë për ngritjen e vetëdijësimin, po diçka ma konkrete për shembull? A ka qenë edhe historiku...

Hidajete Osmani Bytyqi: Ka qenë historiku i Lidhjes së Prizrenit dhe njëkohësisht thirrja për...

Anita Susuri: Bashkim...

Hidajete Osmani Bytyqi: Për bashkim kombëtar po e para ka qenë sa më kujtohet për Lidhjen e Prizrenit, për Kosova Republikë.

Pjesa e Dytë

Anita Susuri: E ju thatë që keni ndërpre pas burgosjes të babës t'juj lidhjen me kto vajzat, qysh ka vazhdu pastaj, a keni vazhdu me tjetrtë apo...

Hidajete Osmani Bytyqi: Nuk kom qenë ma kështu e kyçun me ndonjë organizatë nuk kom qenë. Vetëm me shoqëri, bisedat kanë qenë krahas studimeve, brenga e jonë ka qenë liria, çlirimi nga Serbia, Republika. Ni formë për me pasë ni liri ma të madhe. E kemi mendu edhe luftën po kur erdhi lufta ne patëm fëmijtë e vegjël. Djaln vetëm një vjeç. U dasht me ikë për Shqipëri se prej shtëpive na nxorën këtu.

Anita Susuri: E në vitin '81...

Hidajete Osmani Bytyqi: Vitin...

Anita Susuri: 11 mars që ka qenë demonstrata e parë '81-ten. A keni ditë ju paraprakisht që po organizohet diçka?

Hidajete Osmani Bytyqi: Jo. Me 11 mars unë kam qenë në punë atëherë. Kom punu në Sllatinë si absolvente. Po pata arritë ni shok i babës e lshoj atë vend t'punës. Qysh ka mujtë ai, Binak Ulaj, edhe ai

ka qenë me babën i dënuar. M'ka thirrë kom shku n'punë. E kom fillu punën n'janar. Me 11 mars vllau u vonu shumë, Rabiti, vllau i madh. Mas meje osht' po, se dy vllazën i kam, motra nuk kam. Ai u vonu tanë natën, erdhi, kur erdh n'mëngjes. "Çka u ba?" Kur po tregon qysh ka ndodhë ngjarja. Janë mbledhë te Mensa e Studentëve, tanë natën t'rrethun prej policisë, qysh i kanë shpërnda.

E ndjeva vetën keq pse s'pasna qenë e informune po edhe sipas gjitha gjasave ka qenë si, jo shumë me organizim t'madh e momentit, e çastit aty. Unë si, e kam pasë shtëpinë aty nuk kam shku në mensë m'u ushqy edhe s'e kam pasë atë fat me qëllu aty. Po pastaj në të gjitha demostratat kom marrë pjesë. Prej 01 prillit, 02 prillit. Shkoja në punë në mëngjes e kom pasë ndrrimin. Prej punës në demonstratë. Deri...

Anita Susuri: Çka keni pa n'qato demonstrata? Qysh ka qenë ballafaqimi i popullit me rendit atëherë ligjin? A ka pasë dhunë fizike?

Hidajete Osmani Bytyqi: Demonstrata e 01 prillit ka qenë shumë masive, qysh dihet edhe prej historisë, prej fotografive që i keni pa. Na kanë ndjekë niherë me gaz lotsjellës me na shpërnda kësaj rrugës mbi kuvendin, prapa teatrit. Pastaj përsëri jemi grumbullu kemi dalë prapa andej kah, ku osht' tash Sheshi i Skënderbeut dhe kemi qëndru me orë të tëra. Brohoritje. Dikur përsëri na kanë qit' gaz lotsjellës. Na kanë shpërnda. Me 2 prill ka vazhdu mbi Mensën e Studentëve. Këndo, brohorit edhe rruga ka qenë duke u ndërtu.

Gypat e mdhej të kanalizimit, djemtë studentët... policia poshtë te Mensa e Studentëve, ne i rrokullisnim gypat te poshtë. Aty osht' vra pastaj ni, nuk më kujtohet emri kush osht' vra po prej ni familje serbe thojshin osht' vra mbi, përballë Mensës së Studentëve...

Anita Susuri: Naj serb u vra a? Prej policisë?

Hidajete Osmani Bytyqi: Jo shqiptar. Ni student, po nuk po më kujtohet emri.

Anita Susuri: S'ka lidhje.

Hidajete Osmani Bytyqi: Kështu kanë vazhdu. Me 11 prill mandej kemi shku në vizitë te baba në Mitrovicë. Se në atë kohë ishte ai në Mitrovicë. Me 1 maj kanë ardhë me më burgosë në '81-ten. Nuk deshta niherë me u, masi s'qëllova në shtëpi, e mora lajmin për kontrollën e shtëpisë edhe kom mbetë te dajhtë. Mandej kom kalu në ilegalitet deri me 4 gusht. Kam tentu, pata disa, me dalë jashtë. Qëllimi ka qenë me marrë ni pasaportë fallco, po nuk arrita me siguru. Me 3 gusht e vendosa me, thashë, po shkoj në burg sa të më dënojnë le të më dënojnë e kryj dënimin se nuk jetohej në ilegalitet.

Anita Susuri: E në ilegalitet me jetu qysh ka qenë? Keni jetu dikund...

Hidajete Osmani Bytyqi: Nëpër disa shtëpi po kryesisht te dajtë kom qëndru edhe te një shoqe nja ni javë, ni Besa Halimi, tani është e ndjerë. U ktheva në shtëpi, u përshëndeta me nanën edhe i mora ni valixhe me rroba, shkova. Kur shkova nuk kish qenë ai, ni Faik Nura dhe Lutfi Ajazi ka qenë ai operativisti kryesor që më ka marrë në pyetje. Nuk kish qenë aty. Tha, “Dil edhe pak e shëtitu, eja më vonë”. Isha me vllaun. Shkum e bëmë... me vllaun e vogël, Ylberin.

“Hajde”, thashë, “ta bojmë ni fotografi se pale kur shihemi”. E bëmë atë fotografi. I kisha floktë e gjata. Thashë, “Kta pale çka m’bajnë m’i shkulin floktë, “Hajde po shkoj p’i prej floktë”. Jom shku prej aty... ma dhanë edhe ni rast m’i pre floktë (qeshë). I preva mandej u ktheva aty, hyna brenda. Një natë e kam kalu aty...

Anita Susuri: Në Prishtinë a?

Hidajete Osmani Bytyqi: Në Prishtinë në sekretariat. Në pyetje, oferta ni si dajë i gjyshit ka qenë ai Ibush Kllokoqi erdh tha, “Hajde po dalim, p’e pijmë kah ni kafe edhe trego krejt çka ki me tregu edhe shko ti në shpi. Trego kush t’ka shti e kush të ka thanë e çka të ka thanë”, thashë, “Me ty nuk kom punë”, tha, “Jemi t’afërt familjarisht”, jo shumë të afërt po daja, baba i tij dajë i gjyshit. Thashë, “Me ty edhe në kësi mënyre nuk kom ardhë me bisedu”. Prej atij momenti ma ai osht’ largu. Të nesërmen m’kanë vendosë, e kanë vendosë për paraburgim edhe më kanë dërgu në Mitrovicë.

Në Mitrovicë mandej kanë qenë marrjet në pyetje vetëm natën. Orët nuk na i kanë leju, po masi, në ora 09:00 e kemi pasë me ra me fjet, masi gjumi s’na zinte... po natën vonë mas 12:00-tve vishin na merrshin e na nxjerrshin prej burgut në sekretariat. Aty afër kanë qenë me burgun në Mitrovicë. Në pyetje natën. Provokime të ndryshme, jo ai ka thanë jo kështu ka thanë, po gjithmonë...

Anita Susuri: Dhunë fizike ka pasë sigurisht?

Hidajete Osmani Bytyqi: Jo sa shoqeve (buzëqeshë), ma pak. Krahastuar me, tregova për rrahjen që i kanë ba Hatmone Haradinajt edhe Mihrije Krasniqit e jemja nuk është për m’u përmend.

Anita Susuri: M’tregut që jeni, keni shku faktikisht vullnetarisht n’burg. Qysh kanë qenë këto hetimet? Sa kanë zgjatë hetimet fillimisht?

Hidajete Osmani Bytyqi: Hetimet kanë zgjatë nëntë muaj. Pesë muj e gjysë nuk kom pasë të drejtë as vizitë, nuk e kom pa familjen fare veç kanë ardhë çdo dy javë pakot me ushqim edhe rrobat që i marrshin me i la. Se aty s’kem pasë kushte për m’i la. Pa vizita do të thotë pesë muj e gjysë. Mandej kanë fillu vizitat dy herë në muj prej, me 01 dhe me 15 me kusht me qenë ditë pune.

Anita Susuri: Ju thatë që t’njejtën kohë keni qenë edhe me babën...

Hidajete Osmani Bytyqi: Të njejtën kohë babën e patën kthy, e kanë kthy prej Sllovenisë e kanë kthy në Burgun e Mitrovicës. Baba i ka pasë vizitat vetëm të shtunën ose të dielën, për vikend. Kështu që nënës time i është dashtë me ardhë në Mitrovicë për ata katër muj, katër herë në muajt. Dimri ka qenë ma i vështirë. Atëherë veturë nuk kemi pasë, me autobus. Prej stacionit të autobusave mandej burgu ka qenë bukur larg. E kemi pasë, nana e ka pasë ma së vështiri në atë periudhë.

Anita Susuri: E ju çfarë aktakuze keni pasë kur jeni gjyku? Për çka?

Hidajete Osmani Bytyqi: Na akuzë për pjesëmarrje {e merr një dokument}, qitu e kom këto... për pjesëmarrje në demonstratë edhe kundër shtetit.

Anita Susuri: Kundërrevolucion.

Hidajete Osmani Bytyqi: Kundërrevolucion. Në aktgjykim pra shkruan, “Është fajtorë sepse me qëllim të rrëzimit të pushtetit të klasës punëtore dhe të punonjësve mbi rrënimin e rregullimit shoqëror ekonomik të përcaktuar në kushtetutë, thyrjen e vëllaznim-bashkimit anti kushtetues të rregullimit federativ të RSFJ-së, me 01 prill 1981 mori pjesë aktive në demonstratat armiqësore që janë organizuar dhe zhvilluar në rrugët ‘Ramiz Sadiku’ dhe ‘Marshal Tito’ në Prishtinë dhe atë prej kohës 13:30 deri në ora 19:00”, thashë kanë qenë shumë të gjata. “Me çrast bashkë me të tjerët brohoriti parollat me karakter armiqësor ‘Kosova Republikë’, ‘Lironi shokët nga burgu’, ‘I duam shokët e të tjerë’”. Kjo ka qenë akuza kyçe.

Anita Susuri: E qysh mendoni që kanë ardhë ata deri te ju që ju kanë zbulu juve?

Hidajete Osmani Bytyqi: Zbulu në fotografi përmes fotografisë, pjesëmarrje në demonstratë. Janë ato fotografi po janë... ma kanë tregu fotografinë. E shkaku aty ka pasë edhe të tjerë po identifikuar si bija e Kadri Osmanit, jam burgosë unë.

Anita Susuri: E gjykimi qysh ka qenë? Ju individualisht jeni gjyku?

Hidajete Osmani Bytyqi: Veç vet, nuk kom... kanë tentu me m’bashku me shokë po unë thashë që ata që i kam ditë unë edhe e kam ditë që s’ka lidhje me të tjerët, emrat e tyre nuk i kom përmend kurrë. Nuk kanë arritë me m’ba bashkë me kërkond. Jom dalë vet në gjyq. M’kanë dënu dy vjet. Pas përfundimit të gjykimit, m’kanë dërgu në Burgun e Lipjanit. Atje ka qenë pak ma e lirë. Aty mandej jam njoftë me Gjyle Krasniqin.

E pas burgut jom njoftë me Lumnie Azemin. Për të cilën kisha dëgju edhe në Burgun e Mitrovicës kështu kemi qenë njëkohësisht të burgosura po qysh komunikojshim nga dhoma në dhomë nganjëherë kur e dishim që nuk janë gardianet aty. Nganjëherë na mashtrojshin, dalshin me çorapë. I hjekshin taket edhe... ni rast që ka qenë ma i vështiri për një Kadrijen, Kadrie Gashin. Dul gardianja,

Fevzie, mbiemri s'po më kujtohet. Ka dalë me taka, se dëgjoreshin. U mbyll dera ajo i ka heq taket e u kthi në zyre.

Na nuk e kemi vrejtë. Na kemi fillu me këndu me bisedu edhe në moment kur janë çelë dyert njëna pas tjetrës. Kond e ka pa... se ka ardhë i ka pa, thojshin, shpihunka ajo qysh, vrima në derë. I ka vrejtë. Na jemi dhanë pas kangës e pas bisedës nuk e kemi vrejtë që ajo osht' kthi se osht' kthi në mënyrë tinzare. Mandej e kanë marrë Kadrie Gashi, ni Fatime Seniku prej dhomës tonë e Gjylën prej dhomës tjetër. Kadrie Gashin e kanë pasë rrahë shumë keq. Saqë thojshin ia ka lëndu synin, osht' prej synit shumë keq. Ni kohë shumë të gjatë e ka pasë synin keq. Ajo ka qenë ni rast ma i rand që ka ndodhë edhe që e kemi përjetu keq.

Anita Susuri: E qysh ka ndodhë ky komunikimi i shoqeve brenda burgut?

Hidajete Osmani Bytyqi: Thashë, kur na merrte mendja që dolën naj pauzë ata edhe natën sidomos, e kemi shfrytëzu për me... me trokitje në mur e kemi pasë {i mshon tavolinës tre herë} "Republikë, Kushtetutë, ja me hatër, ja me luftë!" E kemi pasë ritëm. Dy-tri herë prej dhomë në dhomë. Kur nuk dëgjohej asni zhurmë tjetër naj reagim i gardianëve pastaj zhvillojshim biseda të ndryshme.

Anita Susuri: A ka pasë për shembull...

Hidajete Osmani Bytyqi: Me ditë kush erdhi, kush doli, kush shkoj, kush...

Anita Susuri: Informata prej jashtë...

Hidajete Osmani Bytyqi: Informata kur vishin. Se në '81-ten gjatë, prej 1 prillit e deri në, thojshin që ka pasë edhe mbi 20 të burgosura me ni dhomë. Se vetëm katër dhoma kanë qenë për vajza, e ka pasë shumë kështu të burgosura për kundërvajtje nga ni muj, dy muj ka pasë shumë. Në fund unë ma vonë kom shku, atëherë veç janë liru. Prej 4 gushtit nuk ka pasë fort shumë. Po ato parapraket tregojshin që kanë qenë dhomat e stërngarkune.

Anita Susuri: Brenda burgut a keni pasë edhe aktivitete që ju kanë shti me bo? Punë ose diçka? Qysh e keni kalu për shembull ditën?

Hidajete Osmani Bytyqi: Në Mitrovicë jo. Në Mitrovicë e kemi pasë shëtitjen dy herë në ditë nga 15 minuta. Ni oborr i rrumbullakët. Se Burgu i Mitrovicës është i rrumbullakët. Në Burgun e Mitrovicës nuk na kanë shti me punu. Po shëtitjet i kemi pasë dy herë në ditë. S'di a e dini Burgu i Mitrovicës është i rrumbullakët edhe thojnë është ni arkitekt kush e ka punu, më duket thonë që ka bo edhe vetëvrasje ma vonë. Osht' folë kështu.

Osht' i rrumbullakët, brenda burgut rrethi pastaj shëtitorja edhe ajo është e ndane në katërsh. Në mesin ka qenë ajo roja që ka qenë gjithmonë nën vëzhgim. Ne kemi dalë edhe është dashtë m'u sjellë në rreth shëtitja, durt pas {vendos duart prapa shpinës}. E ne mundoheshim me naj kollitje, me naj, veç me shkakti pak zhurmë me tregu që jemi gjallë aty e s'po frikësohemi. T'u u mundu, kokën lart. Me kesi shenja me tregu ni krenari për mos... me ditë ata që ne nuk jemi pendu për ato që kemi ba edhe nuk po na vjen keq që jemi në burg se kemi qenë për një çështje kombëtare.

Anita Susuri: E Burgu i Lipjanit?

Hidajete Osmani Bytyqi: Ky ka qenë... e Burgu i Lipjanit na kanë shti me punu. Niherë më kujtohet edhe e kam ndi vetën keq edhe nuk di, shpesh më kujtohet pse s'kom reagu edhe pse kom shku me fshi zyren edhe shtëpinë e, zyrën, drejtorinë e burgut. Ni Shpresa Kuqi ka qenë drejtoreshë. Me i fshi xhamat, me ia fshi zyrën. Po ajo ka ndodhë niherë ma atje s'kom shku. Mandej na kanë pasë çu neve të burgosurave politike në kursin për rrobaqepësi. Kursin për rrobaqepësi e kom nifar', na kanë pasë dhanë ni certifikatë. E kom edhe ni diplomë të burgut (qeshë).

Kemi qepë pelena për spitale na kanë pasë pru niherë. Atëherë në '82-ten thanë, nuk ka spitali pelena. Ato i kemi qepë me knaqësi se e dishim që po shkojnë për Spitalin e Prishtinës. Aty ka qenë jeta pak ma e lirë. Televizionin e kemi pasë po rrallë që kemi shiqu. Mblidheshim shoqet gjatë ditës. Kanë qenë disa gardiane besa të mira. Nifar' Bedria më kujtohet që nuk na kanë pengu edhe kur jemi mbledhë pas pavijonit në oborr, në shëtitore edhe kemi këndu këngë të ndryshme.

Anita Susuri: Këngë patriotike...

Hidajete Osmani Bytyqi: Patriotike sigurisht. "Po i bjen era retë e zeza", kjo më kujtohet ma së shumti. Me Gjyle Krasniqin, me Dinore Currin. Edhe ajo ka qenë e dënune 13 vjet, prej Vuqiternës.

Anita Susuri: Njëmbëdhjetë po më duket.

Hidajete Osmani Bytyqi: S'di a e keni intervistë ata? A keni bisedu?

Anita Susuri: Jo ende po e di për to.

Hidajete Osmani Bytyqi: Edhe me Dinore Currin, Drita, Shkurte Kuqi edhe ajo e Deçanit. Tjerat të burgosura politike edhe Gjyle Krasniqin nuk po më kujtohet që jom taku aty. Ka pasë për vrasje disa gra po arsyen pse e kanë bo vrasjen ka qenë arsye e tyne. Po kështu kanë qenë gra të mira s'kemi pasë probleme, s'kemi pasë konflikte. Po edhe na kanë dashtë.

Anita Susuri: A keni mbajtur ndoshta ndonjëherë greva urie për ndonjë vendim...

Hidajete Osmani Bytyqi: Nji herë ni grevë e kemi ba për Gjyle Krasniqin. Se e çun në vetmi, nuk di arsyen pse e kishin çu në vetmi. Na e bom ni grevë pastaj e lirun. Ditën kur jom liru në nëntor me 18 nëntor ka qenë dita ma e vështirë. Se Gjyla e pat' ni krizë shpirtërore e ndjeu vetën keq që unë po dal. E bani ni reagim mandej i dhanë qetësues. Nuk e di atë ditë qysh kom dalë prej burgut. Ma me dëshirë kisha nejt atë ditë e m'u nda naj mënyrë tjetër prej Gjylës se ashtu qysh jom nda.

Mandej ata e kanë marrë e kanë çu në Pozharevac. Ajo ka pasë vujtje shumë të mëdha. Se si e mitur e kanë keqpërdorë ni, tregojke për nifar' punëtori operativ. I Banjës ai, Luma, Mehmet Luma. Që ka ba ç'mos me tregu shoktë e... ajo ju tregon ma s'miri nëse keni rast me bisedu me të, se jeton tash në Zvicër...

Anita Susuri: Sa ka qenë e dënuar?

Hidajete Osmani Bytyqi: Sa ka qenë e dënuar? Nuk e di.

Anita Susuri: Ma shumë se ju ndoshta?

Hidajete Osmani Bytyqi: Ma shumë, ma shumë. Atje në Pozharevac e ka vazhdu mbajtjen e burgut.

Anita Susuri: Ju dy vite të plota i keni mbajtë apo?

Hidajete Osmani Bytyqi: Jo unë kom mbajtë 15 muj e gjysë se gjygji tre muj e gjysë para se me fillu hetimet nuk m'i kanë llogarit fare. Mandej gjygji suprem ma ka heq ni vit. Burg i kom mbajtë 15 muj e gjysë.

Anita Susuri: Atë ditë kur keni dalë prej burgut, më tregut po a ka qenë dikush me ju pritë a kanë ditë që keni me dalë saktë?

Hidajete Osmani Bytyqi: Po. Po, po, po. Atë ditë... besa për ni ditë nana e ka përgatitë drekën ni ditë ma herët se prej datës qysh jom burgosë e qysh e ka llogaritë e mu të nesrit m'kanë liru.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: Po këtu takime me nanën e juj, me familjarët qysh ka qenë gjendja e tyne karshi me juve? Qysh i keni pa ju ata që janë? A ju kanë dokë që po shqetësohen shumë ose po ndjehen keq?

Hidajete Osmani Bytyqi: Nana gjithmonë ka qenë edhe vllaznit janë mundu me m'dhanë kurajo mu mos m'u mërzi edhe kurrë mërzi te ata nuk kam vrejtë, nuk kam pa kurrë, nuk... e kemi pasë të ndalune m'u mërzi atëherë. Tash po mërzitemi për atëherë.

Anita Susuri: Po paraprakisht deshta me ju pytë edhe për... se te ai libri e kom pa që jeni taku me Kadri Zekën po atëherë nuk e keni ditë që është...

Hidajete Osmani Bytyqi: Nuk e kam ditë që është Kadri Zeka.

Anita Susuri: Kjo ka qenë para burgosjes?

Hidajete Osmani Bytyqi: Para burgosjes, po.

Anita Susuri: Qysh kanë qenë këto...

Hidajete Osmani Bytyqi: Mehmet Hajrizi na ka lanë lidhjen për... se në çdo muaj e kemi pasë ni takim mbi Mensën e Studentëve do, nuk e di, i kam... po ni herë në mujt ata si lloj rroge e kanë pasë për, ku i kanë mbledhë të hollat ata e dijnë, populli ku i ka dorëzu i kanë dhanë mërgimtarët. Me ni rast nuk e di pse Mehmet Hajrizi e ka ndërpre edhe kish, ma përshkru ni njeri me syza me... “Takohesh diku përmbi”, nën shtëpinë tonë, kah konviktet. Isha konë pasë taku me Kadri Zekën e nuk e kom ditë.

Anita Susuri: E mas burgut a e keni vazhdu aktivitetin a qysh ka vazhdu jeta ju? Se për shumicën ka qenë, për shembull, e ndalune edhe puna edhe me marrë pjesë në shoqni.

Hidajete Osmani Bytyqi: Mas burgut unë kom qenë ende e pa diplomuar. Ju kom kthy studimeve edhe në fakultet m’kishin pasë dënu me ni vit heqje të drejtën e studimeve. Po fakulteti e ka kry atë dënim, nuk ma ka përmend kurrë. Vetëm listën që e kom pa. Brenda kohës që e kom kry burgun u kry edhe dënimi i ndërprerjes së studimeve. I kom vazhdu studimet, i kom kry. E mandej të drejtë pune nuk kom pasë. Tetë vite nuk kom punu.

Kom konkuru edhe për konduktere të autobusave. Kanë pasë dalë atëherë autobusat edhe kondukeret e para autobusat e qytetit. As aty nuk më kanë leju me punu. Nuk më kanë pranë. A në fabrikë të armaturës, a si përkthyes se e kom pasë edhe përkthim certifikatën si përkthyes e shkallës së dytë me shkrim, shqip-serbo kroatisht, serbo kroatisht-shqip, si përkthyes. Kërkund tetë vite.

Në fund pak para se m’u njoftë me Nuhiun, bashkëshorti është [Nuhi Bytyqi](#), edhe ky ish i burgosur politik. Me shtatë vite burg i dënuar ‘81-ten, pesë i ka mbajtë dy ia ka zbrit gjygi suprem. Mandej na njofton shoqëria se një e burgosur politike dhe një i burgosur politik e kanë pasë pak ma vështirë m’u martu me të tjerët. Ne gjetëm ni gjuhë të përbashkët. Në atë kohë kur jemi njoftë, unë kom punu në Komitetin për Bujqësi dhe Pylltari si përkthyes. Nja tetë muaj.

Enti për Kuadrim m’thirri, nuk e di qysh ka qenë ajo mënyrë e punësimit, në telefon. “Shko po kërkohet ni përkthyes”, edhe kom punu në qat’ kohë. Pas martesës n’vitin 1987 kom ardhë këtu me shpresë që

në Prizren nuk më njohin. Me mbiemër Osmani ndoshta ka me pasë mundësi m'u punësu. Disa të njohur na kanë pasë premtu sot nesër, sot nesër, e nuk u bë ajo nesër me vite të tana. Deri në vitin 1994, '95 në nëntor Nexhmije Bytyqi osht' motra e ni shokut të Nuhiut.

Ajo ishte zgjedhë drejtoreshë e shkollës "Fadil Hisari" në Prizren. E m'ka thirrë në vendin e saj me punu arsimtare e gjuhës shqipe. Prej atëherë kom punu vazhdimisht. Çka u patën bo shtëpitë shkolla, u pat' bo ni ndryshim që pat' mundësi ajo m'u zgjedhë drejtoreshë. Nuk jemi njoftë personalisht, veç e ka ditë që shoku i vllaut të saj të ndjerë është martu me ni profesoreshë të gjuhës shqipe. Nuhiu u pat' burgosë, në burg ka qenë në atë kohë...

Anita Susuri: Sa keni qenë ju t'martun ka qenë në burg?

Hidajete Osmani Bytyqi: Po, në burgun e dytë.

Anita Susuri: Sa vite e keni prit?

Hidajete Osmani Bytyqi: Dy vjet. Pasi jemi martu osht' burgosë. Në qat' kohë kur jom punësu unë Nuhiu ka qenë në burg, kur më ka thirrë ajo Nexhmije Bytyqi. E kom vazhdu punën. Jam mirënjohëse edhe sot që jom në punë, jom mirënjohëse që ajo ka qenë e para që ju ka kujtu edhe që e ka shfrytëzu atë mundësi për punësimin tim.

Anita Susuri: E qysh ka qenë për juve këto vitet '88, '89 kur fillun ato marshet e minatorëve fillimisht pastaj punëtorët e fabrikave, pastaj greva?

Hidajete Osmani Bytyqi: Po si e martuar e kom pasë të kufizuar pjesëmarrjen. Grevën e Minatorëve kam qenë shtatzanë me Fitoren, vajzën e dytë. Bile kur më lindi t'u shpresu që tash po fitojmë, tham, po emërtojmë vajzën Fitore. Diçka të asaj kohe janë Fitore, ka shumë Fitore të asaj periudhe. Edhe ato kanë qenë vite të vështira. Nuhiu u burgos e mbajtën dhetë muj në burg. U dënu me dy vjet.

Deri në burgosjen tjetër aty kom pasë, i kom pasë bo pak lutje, pak presion po nuk shkoj deri në fund për me dalë jashtë, me ikë. Se s'kish ma. Pa punë, i rrezikun m'u burgosë përsëri. E kish veç me prit vendimin edhe me shku m'i majtë edhe 14 muj tjerë. Nuk u bind edhe e vazhdum me ato peripeti e vazhdoj burgun për së dyti edhe 14 muj edhe mandej krisi lufta. E të gjitha ne vendosëm me qëndru në Kosovë.

Po fatkeqësisht ky qëndrimi jonë në Kosovë nuk na boni të mundshme që rinia mos me hjekë. Na ka ardhë puna neve, djali me dalë jashtë. Tash po presim edhe pak, ka hy në test për me mësua gjuhën gjermane. Nusën e ka jashtë edhe me shku edhe ky. Jo që është njoftu me nusen e që është nusja kusht me dalë ai jashtë, para se m'u njoftu edhe ma i ri ka qenë, "Ku m'i rritë fëmitë këtu, a rriten

fëmitë me këto rroga të vogla, ju lumtë juve qysh na keni rritë neve po unë nuk mendoj m'i rrit fëmitë e mi kështu", kjo ka qenë.

Anita Susuri: E vitet e '90-ta që thatë shtëpitë shkolla a ju ka ra juve, po mendoj, sigurisht ju ka ra me punu jashtë objektit shkollor?

Hidajete Osmani Bytyqi: Jo në shkollë kemi punu. Shkolla jonë nuk ka pasë nxanës në gjuhën serbo-kroate. Fadil Hisari s'ka pasë, për këtë arsye kemi punu në objekt. Po në Shtëpi të Kulturës nuk kemi pasë të drejtë me shku. M'kujtohet një ditë të shkollës e kemi festu ditën e shkollës në xhami. E kemi pasë ba shtëpi kulture. Shumë ka qenë... nuk di a ka dokumente, a ka naj inxhizim po e kemi pasë organizu ni ditë shkolle shumë të mirë në xhami. Në Tusuz.

Anita Susuri: E në kohën e luftës, po mendoj, brenda Prizrenit sa e di ka qenë pak ma qetë, t'u pasë parasysh që në rrethin kanë ndodhë shumë masakra. Për shembull në Suharekë. Po qysh ka qenë për juve qato muj, qato vitet?

Hidajete Osmani Bytyqi: Ne në qershor, djalën e kom pasë tre mujsh kur kemi ardhë këtu në këtë shtëpi. Se e kemi pasë shtëpinë brenda lagjes në anën tjetër. Ni lokal e kemi pasë këtu poshtë. Sa pije burrat që vishin pijshin birra, langje. Edhe Nuhiun ajo dita kritike, dita e Bajramit e ka zanë poshtë në lokal. Kur kanë fillu krismat me 28 prill, a po?

Anita Susuri: Po.

Hidajete Osmani Bytyqi: Me 28 prill...

Anita Susuri: Ose mars.

Hidajete Osmani Bytyqi: Mars. I kemi pa njerëzit në rrugë që kanë fillu me dalë, me ardhë prej Krushës ata kishin qenë. Po na s'kishim... prej Krushës e prej të gjitha fshatrave. "O ku po shkoni, ku jeni t'u shku?" Dolëm n'dritare, "Ku jeni more t'u shku? Ku jeni t'u shku?" Kërkush asni za. Besa ni ditë përpara me të 27-tin e me të 28-tin kanë fillu krismat në lagje edhe njerëzit në kolonë. Fillun në fund atje shiheshin djegia e disa shtëpive. Nuhiu nuk ka guxu ma me dalë për dere, me hy në shtëpi prej lokalit e me hy në shtëpi.

Me pa prej cilës dritare ka dalë jashtë, mrapa shpisë. Tash po tallemi nganjëherë po i thojmë, "Hajde a po del, ta provojmë të shohim qysh ke dalë?" Vet i treti ka dalë për atë dritaren e vogël të banjos. Mandej unë me kunatën, të ndjeren Mihrijen, e kemi tërheqë me çarçafa e kemi shti mrena. Se kjo pjesë ka qenë e pa ndërtune. Për tavani... se janë dy shtëpi të ngjitura. Kjo pjesë ka qenë anej kemi jetu bashkë, kjo ka qenë e pa ndërtune. Përmes tavanit kemi shku e kemi dalë në këtë pushimoren këtu e kemi tërheqë me çarçaf Nuhiun e kemi shti mrena.

E kemi masku me ni kapelë. Djalin e ka marrë në dorë edhe u detyru me dalë jashtë, m'u nisë në rrugë pa kry, s'dishim ku po shkojmë. Kur kemi dalë në rrugë te dera ni kanal e kemi pasë, këtu ku e nalët ju veturën, para hekurudhës. Ni polic... na kalum, unë kunata me shtatë fëmijë kalum. Vjehrrri, axha i burrit edhe Nuhio pas nesh. Polici i ndali, "Qitni pare". Na të gjitha të hollat çka na dërgoj kunati prej Zvicrrës i shndërrum në mall, t'u mendu që lufta edhe të kemi ushqim këtu me hangër. Për që po dalim në rrugë nuk e ditëm, se mendum që qetë, qashtu qysh thatë edhe ju. Qyteti pak ma i qetë.

Na shumë pak të holla, s'di sa kemi pasë. "Nuk kemi", "S'keni! Kthehuni!". I nali këta tre burra mrapa. Kur e kom kthy krytë i kom pa këta mrapa, "Çka jeni t'u bo?" Tha, "Qitni pare". Kah 1000 euro a për kokë a 1000 euro i lypën për te tret, nuk e di. Marka a, kah 1000 marka. I kom thanë kunatës, "Mihri kthehu se na nalën", ajo e kish burrin në UÇK. I kishim na obligim m'u kujdesë edhe për ata meqenëse s'e kish burrin aty. Mihrija u kthy edhe unë edhe Mihrija me shtatë fëmi u kthy. U bo grumbull i madh edhe këtu tre burrat edhe gruja axhës.

Ni polic përtej rrugës tha, i bërtiti atij në gjuhën serbe, "Çka osht' ajo? Çka po bon grumbull njerëz aty? Lëshoj njerëzit në kolonë". Se e kishin bo pa marrëveshje. E pësoj ai për fatin tonë. Na ka lëshu kemi hy në kolonë. Në kolonë tanë rrugën te dy anë polic. Na qitshin atë, "Qe UÇK, a p'e doni UÇK? Shkoni tash te UÇK-ja". Të gjitha në gjuhën serbe, mos t'i flas, po më vjen vështirë me përmend. Deri te pazari i Shqipnisë i thojshin atëherë, ti e din sigurisht ku osht'.

Aty ka qenë ni autobus lokal. Më vjen keq që kurrë atë person ma s'e kemi pa. Unë personalisht nuk e kom taku, me shpreh ni falënderim. Edhe pse jom interesu Nuhio ka thanë që ni herë u taku me dikë prej tyne. Po ata na kanë marrë pa asni shpenzim, pa pare veç familjarët e vet i ka pasë nja 17 vet edhe krejt u mush autobusi njerëz. Na ka çu deri në kufi në Zhur. Në Zhur i kanë pasë vendosë disa piramida të mdha të betonit.

Polici tha, "S'muni me shku. Zbriti njerëzit. A ka kalu ni", far' lloj i kamionit, ia përmendi emrin. Se unë isha ulun përpara që e dëgjova bisedën. Tha, "Po", tha, "Nëse ka kalu ai lloj i kamionit edhe unë kaloj me këtë autobus", tha, "Hajt provoje". Kemi kalu përmes atyne barikadave me autobus deri në kufi. Në kufi ai shoferi na tha, "Zbritni ju çka nuk jeni familjar t'mi zbritni se këta kujtojnë që unë po baj njerëz me të holla. Unë po kaloj me familjartë e mi e atje kush t'muni përsëri hyni".

Na kem kalu pastaj atë pjesën zonën kufitare në kam, me fëmi me shtatë fëmi edhe na tjetrtë që ishim. Po fëmive ua kish çu zoti a n'çka m'u thirrë, ni qetësi që ni za s'e kanë nxjerrë nga goja. E kanë ndje pale. Edhe pse kishim, djali ma i vogli një vjeç. Tjetra dy e gjysë e deri në klasën e katërt ka qenë Rilinda ma e madhja. Kemi dalë atje përsëri ka ardhë autobusi, e kish kalu kufinin me familjart. Na ka marrë përsëri edhe na çu deri në Kukës. Në Kukës jemi hy me ni far' shtalle, ni kooperativë. E kemi kalu natën aty. T'nesërmen e kemi marrë ni kombi.

E mira e asaj puna ka qenë që, bllokin, m'u kujtu, bllokin e numrave të telefonave se telefona s'ka pasë celular po bllokun e numrave të telefonit e kom marrë e kom shti në xhep. Mandej me atë numër kemi komunikim me kunatin që ka qenë jashtë. Sa kemi qenë atje na ka dërgu të holla për banesë. Se ishim shumë. Dy familje edhe vjehri. Nuk kish vend. M'u nda nuk dojmë m'u nda. Se atje shtëpitë e vogla, m'u nda kah katër vet me shku nëpër shtëpi s'kishim qysh. Kemi pagu në shtëpi me qera, kemi nejtë me qera derisa ka përfunduar lufta.

Anita Susuri: Qysh e morët lajmin që ka përfunduar lufta? Qysh e pritët?

Hidajete Osmani Bytyqi: E kemi pasë në tranzistor tanë natën kemi dëgju, na ma shumë kemi dëgju lajme, kemi dëgju tranzistorin se që kemi fjet. Përmes tranzistorit jemi informu që lufta përfundoj. Vjehri me t'parët me kunatën edhe me fëmijtë e kunatës që ish kunati Muhamet Bytyqi... ai i pari osht' kthy. Përneherë me NATO-n që ka hi në Prizren ai ka qenë po m'dukët i dyti. Ndër të parët janë kthy në shtëpi.

Shpinë fatmirësisht nuk na kanë prek. Qysh i kemi lanë gjanat qashtu i kemi gjetë. Ni vëlla tjetër e ka Nuhiu përballë këtu ai ka pasë mbetë gjatë luftës këtu. Na ka tregu që policia kanë nejt këtu. Para derës e kemi pasë në bankë kësi të parkut. Kanë nejt, kanë hy mrena, kanë pi ujë deri në korridor po naltë nuk ishin ngjit. Pse, a e kanë lanë për fund kanë mendu hala ma gjatë e lufta u kry shpejt. Cila ka qenë mrekullia që e ka shpëtuar shtëpinë tonë, nuk e di. Po na u kthym në shtëpi e gjetëm shtëpinë mirë. Vazhdum punën menjëherë.

Shtatë klasë e patëm shkollën që mbet në gjysmë që e patëm përfunduar brenda në muji. Kemi kry ato dëftesa edhe kemi fillu në tetor mandej vitin tjetër shkollor. Kom punu edhe në vjet atje te "Fadil Hisari" mandej e bonëm ndrrimin me në koleg. Ai e kishte shtëpinë në Tusuz, Arif Krasniqi në ndoshta e njëjti. Unë ktu e kisha më afër te "Abdyl Frashëri". E bëm këmbimin edhe prej atëherë deri tash edhe deri me 22 dhjetor po punoj te tanimë "Hysen Rexhepi", se ia kemi ndrru emrin shkollës. Dal në pension me 22 dhjetor.

Anita Susuri: Deshta me ju pyetë edhe për ditën e pavarësisë, qysh e keni pritët? A e keni festu? Qysh ka qenë në familjen e ju?

Hidajete Osmani Bytyqi: Dita e pavarësisë ka qenë ëndrra e realizuar e jona familjare e kombëtare. E kemi përjetu me gëzim të madh. Bile kur osht' shpallë atë ditë pavarësia kanë pasë organizu këtu qyteti i Prizrenit në flamur i gjatë edhe ka qenë shumë ditë e ftohtë. Unë me djalit kemi qenë në kolonë. U ngjit djali për flamuri u kap edhe s'ka kush që e hjekë. Kemi shku deri te Lidhja e Prizrenit. Me flamur e kemi bërë atë marshim. Gëzimi ka qenë pa kufi. Po pas lufta, pas pavarësisë, pas gjitha këtyre diçka ky migrimi i rinisë që e përmenda, m'i ardhë dita djalit tim me shku jashtë nuk po di me e gëzu këtë pavarësi.

Anita Susuri: Zonja Hidajete...

Hidajete Osmani Bytyqi: Jemi të gëzuar që s'ka serb këtu ma, po me na ikë rinia kështu... sipas ni lajmi para nja ni muji nashta tash u shtu shifra, "65 mjek e lëshun Kosovën". E 65 mjek me lëshu Kosovën me shku në Gjermani. Gjermania po ka nevojë për mjek tanë. Se neve po na akuzojnë edhe shkollat për PISA, se ku jemi atje. Po rinia jonë e shkollune po shkon jashtë. Kjo është brengë. Uroj që të këndellën politikajt e Kosovës, të punojnë për çështjen kombëtare, të punojnë për Kosovë, të punojnë për rininë tonë, mos t'lejojnë migrimin. Uroj që t'vijë dita e rinia që po shkon atje m'u kthy.

Anita Susuri: Shpresojmë.

Hidajete Osmani Bytyqi: Ju falënderoj për intervistën, kam pasë emocione (qanë). Sidomos ky migrim për mua është shumë i rëndë.

Anita Susuri: E kuptueshme është. Faleminderit juve shumë edhe për kontributin e juv edhe për intervistën, kohën! Faleminderit shumë!

Hidajete Osmani Bytyqi: Diçka çka kam mbetë pa thanë i keni edhe të shkruara se i kanë disa libra Sabile Keqmezi, Mehmet Hajrizi, Teuta Hadri. Janë të shkruara nëpër libra kështu me data ma të sakta.

Anita Susuri: Faleminderit edhe njëherë shumë!